



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:089357  
Datë: 09.01.2024  
Numri i dokumentit: 05167369

**C-III - 15 - 0064**

**Paditësi:** Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. “Driton Hoxha ” nr. 55 , Prishtinë, të cilën e përfaqëson N Xh .

**Kundër**

**Të paditurës:** Universiteti F në Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me 05 janar 2024, mori këtë :

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET si e pa bazuar, kërkesëpadia e paditësit Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë , me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri Universiteti F, që paditësit në emër të fitimit të humbur për shfrytëzimin e pronës së tokës në sipërfaqe 150m2, pjesë e ngastrës nr..., pronë shoqërore Stacioni V Mitrovicë , për periudhën prej dt. 28.10.2011 deri më dt. 24.03.2016, t’ ja paguaj shumën 2,650.00€.**
- II. Secila palë i heq shpenzimet e procedurës.**

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me dt. 29.10.2014, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë është dorëzuar padia e paditësit kundër të paditurit Universiteti F, përfaqësuar nga Z D, për lirim prone dhe kompensim dëmi, me shenjën C. nr. 721/2014.

Në parashtrësë të padisë është deklaruar se NSH Agrokultura, Stacioni Veterinar në Mitrovicë, është pronare e ligjshme e ngastrës nr..., ZK Mitrovicë, me sipërfaqe 7150m2.

E paditura e shfrytëzon në mënyrë të pa ligjshme një pjesë të ngastrës nr..., duke e bërë edhe ndryshimin e destinimit të pronës për parking të veturave. Nga i padituri është kërkuar që ta liron pronën, por ai nuk është përgjigjur.

Me padi ka dorëzuar :

- Certifikatën e pronës UL -71208072- 03349, ZK Mitrovicë ,
- Kopjen e planit,
- Kërkesa për lirim prone , dt. 16.11.2011,

- Kallëzimin penal dt. 31.01.2012.

Më dt. 17.11.2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë ka marr Aktvendim C.nr. 721/2014, me të cilin është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore .

Më dt. 20.01.2015, kjo lëndë është regjistruar në DHPGJS me shenjën C- III- 15- 0064.

Më dt. 28.02.2020, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C-III-15- 0064, me të cilin i ka kërkuar paditësit të plotëson padinë e ushtruar kundër të paditurit, dhe ju janë dhënë udhëzimet e nevojshme për plotësim të padisë.

Më dt. 13.03.2020, AKP-ja ka dorëzuar parashtrësën me të cilën është deklaruar në lidhje me pretendimet në padi, por që me parashtrësën nuk ka vepruar sipas Urdhrit të gjykatës, nuk ka bërë identifikimin e pjesë së ngastrës lëndore me të gjitha matjet gjeodezike siç është kërkuar në pjesën në të cilën ka pretenduar se ju është uzurpuar dhe një llogaritje të dëmit nga shërbimi i AKP-së në vlerësim dëmi, në të cilin pretendon, sikundër nuk e ka precizuar kërkesëpadinë.

Ka dorëzuar :

- Provat e bashkangjitura në padi,
- Kërkesa e Kolegjit F , dt. 15.03.2016, dt. 23.02.2016 për AKP-në,
- Kopjen e planit,
- Përgjigjeje në kërkesë dt. 15.03.2016,
- Ka dorëzuar disa fotografi, dhe aroinqizime .

Më dt. 29.06.2020, DHPGJS, ka lëshuar Urdhër për të paditurin për tu përgjigjur në padi .

Më dt. 23.07.2020, i padituri ka dorëzuar parashtrësën në gjykatë dhe në emër të saj është deklaruar Z D, sipas të cilës është kundërshtuar kërkesëpadia e paditësit, me arsyetim se nuk është uzurpuar prona e paditësit .

Me parashtrësë ka dorëzuar :

- Aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP II, nr. 58/2012,
- Njoftimi dt. 13.08.2016 për AKP-në.
- Marrëveshje kompensimi, dt. 01.09.2012, në mes Kolegjit F dhe I F.

Më dt. 29.07.2020, DHPGJS , ka lëshuar urdhër C-III- 15- 0064, për paditësin AKP për tu përgjigjur në përgjigje të paditurit, dhe ju është përkujtuar se nuk ka vepruar sipas urdhrave të lëshuara më parë për paditësin .

Më dt. 17.08.2020, AKP-ja, ka dorëzuar parashtrësën si përgjigje ndaj të paditurit, me të cilën është tërhequr nga kërkesa për lirim të pronës , por ka kërkuar vetëm kompensimin për shtimin e vlerës së NSH –së. Me këtë parashtrësë është deklaruar për periudhën e kompensimit prej dt. 28.10.2011, deri më dt. 24.03.2016.

Me këtë parashtrësë rapë AKP-ja, nuk e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë .

Ka bashkëngjitur provat të cilat i kishte dorëzuar më herët me padi, por nuk ka dorëzuar ekspertizën gjeodezike për identifikimin e pjesës së pronës së pretenduar, sikur nuk ka dorëzon një listë të dëmit, siç kërkohet me nenin 35 të Ligjit nr. 06/L-086 .

Më dt. 30.10.2020, i padituri ka dorëzuar parashtrësën me të cilën ka kundërshtuar pretendimin e paditësit se ka uzurpuar pronën e NSH –së.

Më dt. 11.01.2021, DHPGJS ka lëshuar njoftimin për përfundimin e procedues me shkrim dhe për caktimin e një seance dëgjimore. Këtë njoftim e kanë pranuar më dt. 21.01.2021, palët ndërgjyqës. Me këtë njoftim DHPGJS përsëri ja ka përkujtuar paditësit AKP se, për mos veprim sipas urdhrave të gjykatës, pasi nuk ka dorëzuar ekspertizë gjeodezike për identifikimin e pjesës së ngastrës kontestuese për të cilën është kërkuar kompensimi, si dhe mos dorëzimi i një liste të dëmit.

Më dt. 21.10.2022, DHPGJS ka caktuar një seancë dëgjimore publike, në të cilën për paditësin ka prezantuar përfaqësuesi N Xh, ndërsa për të paditurin Z D .

Gjykata duke u kujdesur kryesisht në lidhje me përfaqësimin e Universitet F ka konstatuar se Z D nuk kishte autorizim për përfaqësim, e ka ndërprerë procedurën për shkak të mos përfaqësimit të rregullt, por edhe për të vërtetuar faktin se ky Universitet- Kolegj a' është duke funksionuar. Gjykata sipas detyrës zyrtare ka siguruar përgjigjet nga Agjencia Kosovare e Akreditimit, më dt. 01.11.2022, ka vërtetuar faktin se Kolegji F në Mitrovicë, ka qenë i akredituar për periudhën prej tetorit të viti 2013 deri më 30 shtator të vitit 2018, ndërsa pas kësaj periudhe është tërhequr akreditimi i Kolegjit F, Dega në Mitrovicë.

Nga Agjencia Për Regjistrimin e Bisneseve, më dt. 31.10.2022, është vërtetuar fakti se Universiteti F, me pronarë S A, me adresë në Prishtinë është regjistruar më dt. 03.09.2003.

Administrata Tatimore e Kosovës, me parashtrësë dt. 04.11.2022, është deklaruar se Universiteti F në Mitrovicë, është njësi e Universitetit F në Prishtinë dhe është obligues tatimor për periudhën e vitit 2014 deri në ditën në të cilën është deklaruar sipas të cilave është vërtetuar se subjekti Universiteti F, me pronar S A, funksionon dhe është obligues tatimor .

Gjykata pasi vërtetoi faktin se Universiteti F, në Mitrovicë si njësi e Universiteti të Prishtinës, kishte qenë i akredituar dhe kishte funksionuar deri në vitin 2018, përsëri ja dha mundësin paditësit të plotëson padinë .

Më dt. 05.05.2023, DHPGJS përsëri me Urdhër i ka kërkuar AKP-së, të plotëson padinë dhe të dorëzon provat e kërkuara sipas Urdhrave të mëparshëm .

Më dt. 23.05.2023, AKP-ja dorëzoi parashtrësën me të cilën ka bërë precizimin e kërkesëpadisë. Ka kërkuar të aprovohet kërkesëpadia e paditësit AKP dhe të obligohet i padituri në emër të dëmit dhe të fitimit të humbur për shfrytëzimin e pronës me sipërfaqe 150 m2, në pjesën e ngastrës nr. 2908-1, PSH Stacioni Veterinar Mitrovicë për periudhën 28.10.2011, deri më dt. 24.03.2016, të paguaj shumën 2,650€. Mirëpo edhe në këtë rast nuk ka dorëzuar provat e kërkuara.

Më dt. 30.05.2023, të paditurit ju është dorëzuar Urdhri dhe ju është kërkuar të deklarohet në parashtrësën e AKP-së .

I padituri nuk është deklaruar .

### **Arsyetimi Ligjor**

#### **Kërkesëpadia nuk është e bazuar .**

Gjykata ju ka dhënë mundësin që secilës palë ndërgjyqës, të deklarohet me parashtrësë me shkrim për pretendimet e tyre, sikundër që mbajti një seancë dëgjimore më dt. 21.10.2022 e cila dështoi për tu mbajtur për shkaqe procedurale, pasi Z D nuk kishte autorizim për përfaqësim. Gjykata përsëri ja dha mundësin AKP-së, të dorëzoi ekspertizë gjeodezike për identifikimin e pjesës së ngastrës në të cilën ka pretenduar se ju është uzurpuar nga i padituri, dhe të dorëzoi provën për vlerësimin e dëmit .

Gjykata në bazë të pretendimeve të palëve ka konstatuar se objekt i kontestit është kompensimi nga baza juridike e fitimit të humbur për shfrytëzimin e sipërfaqes prej 150m2, të pjesës së ngastrës nr..., ZK në Mitrovicë, për periudhën prej dt. 28.10.2011, deri më dt. 24.03.2016.

AKP-ja, si paditës ka dorëzuar Certifikatën UL 71208072-03349, sipas të cilës ngastra nr. ..., është tokë urbane, tokë ndërtimore, në vendin e quajtur „ F’’ YK Mitrovicë ka sipërfaqe 3703m2, por nuk bëri identifikimin e pjesës së ngastrës lëndore, dhe se dorëzimi i kopjeve të planit dhe dorëzimi i incizimit aerofotografik, nuk janë prova që provojnë dhe vërtetojnë faktin se cilën pjesë të ngastrës me matje gjeodezike në supozim se e ka pasur në posedim, i padituri Universiteti F .

Gjykata në lidhje me periudhën kohore të posedimit të supozuar prej dt. 28.10.2011, deri më dt. 24.03.2016, edhe për këtë periudhë kohore nuk ka dorëzuar asnjë provë të vlefshme që do të vërtetonte këtë fakt sipas të cilit pretendon se i padituri Universiteti F ishte në posedim të pa ligjshëm të sipërfaqes prej 150m<sup>2</sup>.

Gjykata vlerëson se paditësi AKP, si administratore e NSH-ve, ka pasur autorizime publike për të vepruar duke marr veprime sipas detyrës zyrtare, të identifikon pjesën e ngastrës që ka pretenduar se ju është uzurpuar, pastaj personin, datën se kur ju është uzurpuar dhe datën e liritimit, duke i hartuar procesverbalet nga personat që AKP-së, që kanë administruar me pronën e NSH –së.

Gjykata në lidhje me lartësinë e kërkesës në emër të fitimit të pretenduar të humbur për shumën e kërkuar prej 2,650.00€, për 53 muaj për çdo muaj nga 50 .00€, edhe pse shumën e kërkesës nuk ishte e lartë, AKP-ja si institucion me autorizime publike, ajo ka dështuar të vërtetoi së pari përgjegjësinë e të paditurit për dëmin e shkaktuar sepse nuk ka provuar as periudhën kohore të posedimit dhe as pjesën e posedimit të ngastrës lëndore dhe sikundër as dëmin e pësuar si pasojë e mos përdorimit të sipërfaqes së palujatëshmerisë në pronën e NSH –së.

Me provat e dorëzuara si shkresa për lirim të pronës dt. 18.11.2011, që AKP ju drejtohet të paditurit, e cila nuk ka provë se zyrtarisht ju është dorëzuar të paditurit, as me dorëzim me dorë në shkrimore të Universitetit, as me dorëzim me postë, pastaj me Kallëzimin penal të ushtruar në Prokurori publike në Mitrovicë, që është hedhur me Aktvendim PP.II.nr. 58/2012, dt. 18.02.2016, sipas të cilit nuk ekziston dyshimi i bazuar për vepër penale të kryer nga Universitetit F – Z D, sikundër edhe me parashtresë dt. 24.03.2016, të lëshuar nga AKP-ja, vërteton bindshëm se ajo ka dështuar të përmbush autorizimet e veta ligjore, që ka sipas Ligjit për AKP-në 04/L-034, në administrimin e kësaj NSH –je. Pra ajo nuk ka arritur të vërtetoi përgjegjësinë e të paditurit sipas nenit 136 paragrafi 1, lidhur me nenin 140 i Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Kosovës.

Gjykata vlerëson se AKP-ja duke mos provuar pretendimet e veta, me asnjë provë në lidhje me sipërfaqen prej 150 m<sup>2</sup>, si pjesë e ngastrës nr.2908-1, ZK Mitrovicë, pronë shoqërore e NSH Drejtoria e Përgjithshme Stacioni Veterinar, ajo nuk e vërtetoi as periudhën kohore të dëmit prej dt. 18.11.2011 deri më dt. 24.03.2016, krejt kjo sipas parimit të barë së provës neni 31.5 të Ligjit nr. 06/L-086 në pretimin e saj për të kërkuar fitimin e humbur sipas nenit 137 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Kosovës ( LMD –së ).

Gjykata vlerëson se paditësi nuk vërtetoi me asnjë provë të vetme bazën juridike të përgjegjësisë së të paditurit, Universiteti F në Mitrovicë, që është kushte për të kërkuar kompensimin e fitimit të humbur për periudhën dhe lartësinë sipas nenin 169, lidhur me nenin 171 të LMD –së .

Për këtë arsye edhe është refuzuar kërkesëpadia e paditësit .

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

### **Shpenzimet Gjyqësore:**

Në bazë të nenit 63 të Ligjit për Dhomën e Posaçme vendosi që secila palë ti heqë shpenzimet e veta.

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva  
Gjyqtar